



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 180 prot.

Tiranë, më 14.01.2019

VENDIM

Nr. 1, datë 14.01.2019

“Mbi miratimin e deklaratës”

Bazuar në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38, Senati Akademik i UT-së në mbledhjen e tij të datës 14.01.2019:

VENDOSI:

1. Të miratojë deklaratën bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR.MYNYR KONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

DEKLARATË

Senati i Universitetit të Tiranës, duke besuar në vlerat dhe potencialin intelektual të personelit akademik dhe studentëve të tij, mbështetur në parimet mbi të cilat ai funksionon, lirinë e mendimit dhe të shprehjes, autonominë universitare, transparencën, meritokracinë, kolegjalitetin dhe mosdiskriminimin, në mbledhjen e datës 14.01.2019 vendosi të dalë me këtë deklaratë publike:

1. Rikonfirmon mbështetjen e kërkesave të studentëve.
2. Garanton të drejtën e studentëve dhe personelit akademik për zhvillimin normal të procesit mësimor, duke u kërkuar studentëve të Universitetit të Tiranës ndjekjen e procesit mësimor dhe duke respektuar njëkohësisht të drejtën e tyre për të protestuar.
3. Vlerëson personelin akademik të Universitetit të Tiranës dhe rolin që ai ka në këtë proces reformimi dhe përmirësimi të veprimtarisë së UT, integriteti dhe autoriteti i të cilit duhet të mbrohet në të mirë të realizimit të misionit të tij.
4. Garanton plotësimin e programit mësimor për vitin akademik 2018-2019, nëpërmjet zëvendësimit të orëve mësimore të përealizuara për shkak të protestës, duke përshtatur strukturën akademike të vitit 2018-2019.
5. Garanton shtyrjen e afatit të pagesës së tarifave dhe shtyrjen e procedurave të marrjes së dokumentacionit për përfitim burse dhe të studentëve të kategorive të veçanta.
6. Ngritjen e një grupi pune me anëtarë nga Senati Akademik për të koordinuar vlerësimin lidhur me aktet nënligjore të miratuara, i cili i paraqet materialet deri me datë 22 Janar 2019.

Tiranë, më 14.01.2019

SENATI AKADEMIK
I
UNIVERSITETIT TË TIRANËS